

VENDIM
Nr. 152, datë 29.2.2016

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT TE BASHKIA
KORÇË, TË DISA MJEDISEVE TË PRONËS ME EMËRTIMIN “SHTËPIA E
USHTARAKËVE”, ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN “REPUBLIKA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja “b”, 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit te Bashkia Korçë, për Agjencinë e Zhvillimit Rajonal Korçë dhe institucione të tjera, të disa mjediseve të pronës me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në bulevardin “Republika”, sipas formularit për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 530, datë 7.8.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për Universitetin “Fan S. Noli”, në Korçë, të pronës nr. 549, me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në bulevardin “Republika”, Korçë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Arsimit dhe Sportit, Kryetari i Bashkisë Korçë dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Edi Rama

Formular Per Inventarizimin e Pronave Te Paluajtshme Shtetereore
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

(Institucioni : Bashkia Korçe)			Identifikor: Specialist Olgert Leno, Specialist i Pronave Publike Supervizor: Specialist Zhaneta LUBONJA Drejtoreshë DPKZHT Aprovat: _____ Sotirag FILO, Kryetari i Bashkisë							
Fusha e perdorimit te Prones: Administrative										

A			B				C			
Nr. Rend	Zona Kadastr. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Dresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m ²	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/Entiteti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Entiteti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
967	8562	7/449	Shtepia e Ushtrakeve Bulevardi Republika Korçe	Truall nen ndertese Objekt ndertimor Sperfaqja Funksionale	BLV "Republika" Korçe Kati I pare Kati I dyte Kati I Trete	529 m ² 348 m ² 348 m ² 348 m ² 271 m ²	Administrato Administrato Administrato Administrato	Bashkia Korçe Bashkia Korçe Bashkia Korçe Bashkia Korçe Bashkia Korçe	Bashkia Korçe	Bashkisë Korçe do ti kalojë në pronësi sipërfaqja e tre kateve të objekteve ndërtimor . Sipërfaqja e një kati është 348 m ² . Në total të treja katet kanë një sipërfaqe prej 1044 m ² . Bashkisë Korçe do ti kalojë truall funksional prej 271 m ² si dhe truall nën objekt prej 529 m ² Ky objekt do të përdoret si shtëpi e Agjensisë për Zhvillim Rajonal nr. 3. Në këtë sipërfaqe nuk do të përfshihen sipërfaqja e objekteve prej 219 m ² që përdoret nda DRSHPK e cila ka kaluar në pronësi të saj me VKM nr. 76 datë 28.01.2015 si dhe sipërfaqja ndërtimore prej 310 m ² që përdoret si Qendër Rinore + podrum nga MMSR dhe ka kaluar në pronësi të saj me VKM nr. 201 datë 04.03.2015.

PLANIMETRI E KATIT TE DYTË (EKZISTUESE) SH 1:75



PLANIMETRI E KATIT TE TRETE (EKZISTUESE) SH 1:75

